



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 3, datë 30.04.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 30.04.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë ! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Sipas nenit 44 pika “t” të Rregullores se Funksionimit të Këshillit këtë mbledhje plenare do ta drejtoj Unë me detyrën e zëvendëskryetares së këshillit.

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës.

Dritan Burgija: Suksese.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Siç jeni vënë në dijeni dhe nëpërmjet email-it nga Sekretaria, sot kemi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë dhe një informacion nga Qendra Ekonomike Arsimore, të cilat do t'i shqyrtojmë dhe do t'i miratojmë sot.
Ftoj sekretaren të bëj apelin.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

34 Këshilltarë në sallë.

Flutura Kasa : Kryetare mund të bëj një ndërhyrje.

Denisa Luarasi : Po.

Flutura Kasa : Atëhere e urojmë drejtuesen e seancës për ditëlindjen, meqënëse e ke dhe kështu si jubilarë. Uroj të rrish deri në fund të mandatit aty.

Gjithashtu uroj dhe kandidatet gra pavarësisht se janë të krahut të djathtë të kenë suksese në fushatë dhe në mënyrë të veçantë Kryetarin e Këshillit që të vijë të bëjë dorëheqjen këtu.

Denisa Luarasi : Shumë faleminderit Flutura.

Një nga arsytet që unë pata shumë emocion.

Shumë faleminderit dhe i uroj të gjithë kandidatëve që janë këshilltarë, por dhe të gjithë kandidatëve të gjithë qarkut Durrës, të të gjithë partive politike, suksese dhe ne të tregojmë qytetarinë në këto zgjedhje.

Hekuran Markola : Të gjithëve jo, po tonëve njëherë.

Joniada Musaraj : Po, rri re urtë.

Llesh Çuni : I keni çu gjithë në parlament, nuk i merr.

Ardian Muka : Për procedurë.

Denisa Luarasi: Po.

Ardian Muka : Urime zonja kryetare.

Siç e thatë dhe ju mbledhjen e thërret titullari i institucionit në këtë rast kryetarja e bashkisë dhe nuk më duket aspak normale që për të disatën herën nuk është prezente në sallë duke u marrë me fushatë për një forcë politike, e cila thashë kryetarja e bashkisë ka detyrimin ndaj qytetarëve të jetë këtu prezent përderisa thërret ka shqetësime mblidhet këshilli dhe pa justifikim. Nuk duam që të ketë justifikim. Po në qoftë se justifikimi është që po merret me fushatë, për mendimin tim është duke shkuar në drejtimin e gabuar. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Meqënëse kuorumi është i pranishëm, po filloj me mbledhjen. Po ju lexoj rendin e ditës dhe më pas ju ftoj që ta miratojmë.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN MARS 2025
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA TË BASHKISË Durrës PËR VITIN 2025
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË FURNIZIMIT ME UNIFORMË TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË 01.08.2023 TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA Durrës”
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË Durrës PËR VITIN 2024
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN PRILL 2025
Pika 7. Informim Këshilltarëve	INFORMACION NGA QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT MBI PROÇEDURËN E DALJES JASHTË PËRDORIMIT / TJETËRSIMIT TË AKTIVEVE TË PANEVOJSHME.
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Keni ndonjë koment?

Përpara se të kalohet në votim : Ka deklarata të konfliktit interesit për rendin e ditës?

Nuk ka.

Ok, atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro për rendin e ditës?

34 Pro

Kundër?.....

Abstenim?..... s'ka.

Atëherë miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 1**, Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonjës Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi: Përshëndetje!

Faleminderit Kryetare.

Komisioni jonë u mbledh dhe ramë dakort që pika 1 dhe 6, t'i kalojë Këshillit Bashkiak për votim.

Dorina Milja : Pika 1 njëherë.

Xhiliola Doçi: Okej (okay).

Denisa Luarasi: Morëm pikën 1, e marrim me radhë.

Faleminderit zonja Doçi.

Atëherë komente ose pyetje ka për pikën 1?

(Ngren dorën këshilltari Ardian Muka).

Po.

Ardian Muka: Përsa i takon pikës 1, po ashtu dhe për pikën 6, pra për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin mars edhe për muajin prill, neve e kemi ngritur dhe kemi diskutuar shpesh herë. Kemi thënë që do ishte në nderin e bashkisë së Durrësit që nga buxheti i saj për këto shtresa që janë në nevojë, për këto familje që janë në nevojë dhe nuk është që janë numra të ekzagjeruar. Flitet diku një muaj 30, një muaj 35, një muaj 40 familje, të trajtohen më me dinjitet dhe kur them me dinjitet keni parasysh që flitet për familje që marrin 1600 lekë, 3000 lekë, 5000 lekë të reja, flas gjithmonë në muaj. Me një mesatare rreth aq 5.000 lekë në muaj shkojnë po t'i marrësh. Po maksimumi flitet për 14.000 lekë një familje, që normalisht duhet të kenë shumë probleme. Prandaj thashë do ishte në nderin tonë që në buxhetin e ardhshëm tu shihnin me precedencë këto familje. Sepse nuk ka ngelur bashkia e Durrësit, do ishte në dinjitetin tonë njerëzor që t'u shihnin me precedencë këto raste. Natyrisht neve si forcë politike kemi ngritur edhe një propozim që mos ketë minimum jetik nën 200 euro apo 20 mijë lekë të reja, ndofta dhe për bashkisë do të ishte mirë t'u prezantoheshim me një ofertë të një tillë, ndofta.

Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 1?

34 Pro

Kundra?.....

Abstenim?..... s'ka.

Atëherë miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 2**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Përshëndetje të gjithëve.

Atëherë komisioni ynë e miratoi pikën 2 dhe e parashtrojmë sot për votim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Atëherë e ka fjalën Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë zonja Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi: Përshëndetje.

Komisioni jonë u mbledh dhe me kuorumin e nevojshëm miratuam që pika të kalojë për votim në Këshillin Bashkiak..

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komente ose pyetje ka?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 2 të rendi të ditës?

Atëherë 34 pro.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Atëherë miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 3**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj .

Joniada Musaraj: Atëherë komisioni ynë edhe për pikën 3 e votojë me shumicë votash dhe e parashtrojmë sot për votim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

I jepet fjala Komisionit të Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë zonjës Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi: Komisioni jonë edhe këtë pikë e kaloi për miratim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Doçi.

Komente, pyetje?

Atëherë kalojmë votim.

Kush është pro për pikën 3?

Kundër?...

Abstenim?...

Atëherë me 34 vota pro kalohet, miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 4**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë edhe për pikën 4 me shumicë votash e miratuar dhe e parashtrojmë sot për votim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

E merr fjalën Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit Tokës, zonja Joniada Mamo. Jonada, më fal.

Jonada Mamo: Përshëndetje!

Komisioni jonë u mbledh pas shumë diskutimeve në fakt bashkë me përfaqësuesit e bashkisë me kuorumin e nevojshëm vendosëm për miratim për ta hedhur në votim në Këshill Bashkiak. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Mamo.

Komente ose pyetje?

Dritan Burgjia: Po, po....

Jo s'ka gjë zonja kryetare do të flas mbrapa le të flasi zoti Muka përpara.

Denisa Luarasi : Ok.

Ardian Muka : Për pikën 4 unë do thoja edhe si specialist i fushës, si urbanist pra, që ka ardhur momenti, flasim në vitin 2025 që të mendojmë se çfarë po i bëjmë natyrës me tjetërsimet, që neve qeniet njerëzore kryesisht këtu të bashkisë Durrësit, por jo vetëm, edhe në rang nacional flas, po i lejmë brezave të tjerë trashëgimi. Natyrisht unë jam për zhvillimin duke pasur parasysh që e gjithë zona e Gjirit Lalëzit është një zonë që ka marrë një karakter të theksuar turistik, por do ishte mirë që në zona të caktuara dhe atje përveç beton, beton, beton të kishim zona të gjelbërta. Pra jam për zhvillimin, jemi për zhvillimin, por duhet të kemi parasysh që edhe në ato zona dhe ato turistë që do shkojnë, por dhe ato banorë që do jetojnë aty, do kenë nevojë që të shohin dhe pak gjelbërim. Mos shohin vetëm gri, mos shohin vetëm ngjyrën e tullave të kuqe, po të shohin dhe gjelbërim. Pra fakti që neve vazhdojmë të heqim nga Fondi Kombëtar Pyjor, por me vendimet që së fundmi Qeveria Shqiptare ka marrë duke hequr dhe Parqet Kombëtare nga zonat e mbrojtura duke i dhënë të drejtën atyre që të ndërtojnë për resorte turistike, zhvillime strategjike etjer. Në princip nuk jam dakort për këto zhvillime. Thashë nuk jetojmë vetëm ne. Këtu do jetojnë edhe breza të tjerë, të cilët duhet të kemë të drejtë të shohin edhe ata në një pulbardhë, ndonjë një lejlek që mund të vijë atje apo shpend të tjerë shtegtar apo qoftë edhe kafshë që rriten në këto zonat e mbrojtura. Pra në princip jemi për zhvillimin, por ky zhvillim duhet të jetë i kontrolluar, jo i lëshuar kështu. Në këtë momente që ne flasim zhvillimi është lëshuar pa duar. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Muka.
Fjalën kush e do.

Dritan Burgija : Desha ta marr unë fjalën, po.

Denisa Luarasi : Ok.

Dritan Burgija : Përshëndetje të gjithëve!
Është mikrofon i fik. Ma bëni me qëllim më duket.

Ardian Muka : Kryetare fike ti se

Dritan Burgija : Kërkohet dakordësi për nxjerrjen nga fondi i i pyjeve 0.865 hektar tokë.
Është e rëndësishme të kuptojmë të gjithë bashkë këtu që nëse Këshilli Bashkiak refuzon kërkesën, pra të votohet kundër heqjes nga fondi i pyjeve, atëherë procedura ndërpritet menjëherë nga organet qendrore dhe kjo gjë nuk ndodh.

Unë këtu po i cilësoj ca gjëra. Kam përgatitur një material shumë të gjatë, po do mundohem domethënë të jem sa më shkurt, kam nxjerrë vetëm ca nënvizime që mos edhe t'ju lodh.

Është e rëndësishme gjithashtu të theksohet se dhënia e pëlqimit nga Këshilli Bashkiak dhe Vendimi i ministrit duhet të jenë në përputhje edhe me planet e miratuara të territorit.

Ka plan të miratuar atje zotin nënkryetar?

Heqja nga fondi pyjor e një sipërfaqe pylli të rritur në zonën e Ishmit pritet të ketë ndikime të konsiderueshme mjedisore. Pylli ekzistues në zonën bregdetare të Ishmit, Gjiri Lalëzit përbëhet kryesisht nga pisha mesdhetare. Heqja e 0.86 hektar pyll do të thotë humbje e menjëhershme e habitatit që ka ajo zonë. Nga ana pejsazhore prania e pyllit me pisha është pjesë e identitetit natyror të bregdetit të Ishmit. Zëvendësimi i pyllit me struktura ndërtimore do ndryshojë pamjen dhe estetikën e asaj zone që është karakteristike i asaj zone. Pejsazhi natyror do t'i zërë vendin një pejsazhi të ndërtuar, ç'ka mund të konsiderohet humbje e vlerave turistike natyrore të zonës. Duhet marrë parasysh se shumë vizitorë vlerësojnë në Gjirin e Lalëzit pikërisht për këto vlera natyrore që ka. Turistët e huaj e frekuentojnë pikërisht për vlerat natyrore.

Zona e Ishmit njihet për problemin e erozionit, si erozion të tokave ashtu dhe të erozionit të vijës bregdetare. Pyjet, pikërisht ky pyll me pisha është, ka qenë si ka qenë projekti i mëparshëm për të parandaluar pikërisht këtë pjesë të shqetësimeve që ka pasur zona. Dekada më parë është investuar për atë pyll dhe sot duhet të kemi ndjeshmëri shumë të lartë në prerjen e atij pylli dhe zëvendësimin e atij me beton. Pasojat afatgjata të erozionit të shtuar mund të jenë shumë serioze si për vetë projektin turistik që ka bërë kërkesën, ashtu dhe për komunitetin lokal.

S'po zgjatëm më me këtë punën e erozionit, sepse e kam përmbledhur pak a shumë me kaq fjali sa përdora. Shërbimet ekologjike dhe përfitimet afatgjata të pyllit ekzistues, rregullimi dhe i klimës lokale dhe cilësisë së ajrit, rregullimi i regjimit ujor, mbrojtja nga stuhitë dhe era, pasi ky pyll shërben si parapritë e stuhive apo fenomeneve të tjera domethënë natyrore.

Sa i përket detyrimeve ligjore të subjektit për kompensim dhe ripyllëzim, pylli i ri që merr përsipër investitori nuk mund të zëvendësojë menjëherë funksionet e pyllit të vjetër. Pemët e sapo mbjellë do duan shumë, do duhen shumë vite apo dekada që të arrijnë përmasat e densitetit të pyllit aktual. Dhe gjatë kësaj periudhe do të jenë të kufizuara shërbimet ekologjike. Edhe nëse kompania mbjellë të njëjtën sipërfaqe me fidan të ri, kjo është, domethënë nuk do të plotësojnë nevojat që ka zona përsa fola më sipër. Vendndodhja e ripyllëzimit nga ana tjetër duhet të bëhet sa më afër vendit ku do shpyllëzohet. Nëse pyllëzimi bëhet larg, atëherë zona e Ishmit sërish mbetet pa mbrojtje dhe pa përfitimet e pyllit. Përfitimet që dhe shqetësimet që përmenda më sipër. S'po rrij të lexoj më materialin. Pak a shumë i përmblodha në disa pika shqetësimet mjedisore edhe shqetësimet që mund të sjelli prerja e pyjeve atje. Kështu që e deklarojmë votën tonë kundër dhe ju këshilloj që dhe ju të bashkoheni të thellohem shumë përpara se të marrim vendime të tilla. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Burgija.

Po Joniada.

Joniada Musaraj: Atëherë përshëndetje sërish.

Në lidhje me pikën 4 deri diku bashkohem me kolegët në lidhje me shqetësimin që ka në përgjithësi për mjedisin në qarkun e Durrësit. Dua të sqaroj diçka që kolegët anashkalojnë procedurat. Është e vërtetë që kërkohet dakordësia e Këshillit Bashkiak, por kjo dakordësi, ky vendim nuk shkon vetëm, ky vendim shkon bashkë me raportin tekniko-ekonomik dhe fatmirësisht në vitin që jemi, në këto vite që flasim të fundit, ka ndryshuar dhe perceptimi i resorteve turistike. Nuk është e vërtetë që resortet që janë ndërtuar vitet e fundit dhe që pritet të ndërtohen kanë vetëm beton, sepse nga informacioni që unë kam, shumë miqtë tuaj kanë blerë pikërisht këto objektet pa vlerë që ju i cilësoni, vetëm beton dhe i kalojnë pushimet në këto resorte turistike. Në syrin tim resortet që unë kam parë kanë gjelbërim, sepse i rritet vlera. Kanë ndryshuar tashmë nuk është më si dikur në ato vitet që ndoshta keni qenë ju dhe jo ne dhe së dyti objekti që do ndërtohet, detyrimi që shoqërohet me këtë objekt ka lidhje me mbjelljen e pemëve diku tjetër. Po ju them dhe një informacion tjetër që ju ndoshta nuk e dini ose nuk doni ta thoni që resorti që do ndërtohet pikërisht nga kjo kompani Lura, përveç se do të mbjelli këto pemë dhe do kompensojë dhe nuk është pranuar të bëhet pagesë, por mbjellje pemësh ka shfaqur dashamirësinë që dhe më përpara ka dhuruar pemë më përpara, jo vetëm në rastin konkret. Kështu që doja që minimalisht të mbështesni këto investime serioze nga këto kompani serioze dhe në rastet kur bëhet fjalë për cënim, dëmtim të të drejtave të njeriut, ne jemi të parët këtu se e kemi treguar me fakte, me vepra.

Dhe së dyti do të doja të pyesja zotin Muka kur ju flisni si ekspert zoti Muka, a keni dijeni më në detaje në lidhje me planin apo këtë raport tekniko-ekonomik që kërkohet? Apo vini tek ne me mendimin që ne vijmë të përfuturojmë, të pëlexuar dhe pretendoni që mund të lëshoni fjalët pa i menduar, të dezinformoni publikun? Dhe pastaj pasojat publiku, qytetarit, jo ne. Faleminderit.

Ardian Muka: Unë nuk i vura në aspektin personal asnjë nga këshilltarët. Unë për vete nuk kam një shtëpi në atë zonë, edhe në respekt edhe të normave të ambientit jo vetëm, pra dhe të pejsazhit

të natyrës dhe të gjithë. Me thënë të drejtën preferoj mos kem në shtëpi në këto lloj resortesh që kanë shkuar duke e dëmtuar këtë lloj gjëje.

Ajo që do thoja është që natyrisht e kam lexuar materialin, e kam lexuar kryesisht në aspektin ambiental dhe të kujdesit që duhet të kemi ndaj natyrës. Pjesën ekonomike për mua është irilevante, sepse nuk më intereson gjë çfarë taksash do marri apo do paguaj bashkia, kur unë them që në këtë zonë nuk duhet ndërtuar. Është një zonë me ndërtesa shumë intensive, ndonëse të ulëta, por sipërfaqja është shumë intensive. Përsa i përket asaj që ju apo ne, ne apo ju, ju bëj me dije që kur kemi qenë ne, e kemi lënë rreth 35 zona të mbrojtura, ndërkohë që u reduktuan në 20 dhe së fundmi i kanë hequr dhe 8 zona të tjera dhe për fat të keq një nga ato është edhe në qarkun tonë. Ju faleminderit.

Hekuran Markola: T'ja them dy fjalë.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Po Hekuran.

Hekuran Markola: Faleminderit zonja kryetare e kësaj seance.

Kolegët opozitarë kur i dëgjon në teori dhe parimisht duket sikur kanë të drejtë, por në fakt është vetëm politikë dhe politikë e shëmtuar. Pse e them këtë?

Unë e mora fjalën pikërisht vetëm se doli emri Lura dhe unë vij nga Lura. Lura, shtatë liqenet e Lurës e keni dëgjuar, dikush nga ju dhe e ka vizituar, është në Dibër. Dhe mos harrojmë masakrën pyjore ekologjike që është bërë pikërisht nga partia opozitare që mbron mjedisin. Në 92-98-n të gjitha pyjet e Lurës, pishat e bardha, që janë të rralla dhe nuk gjenden as në Ballkan, janë dëmtuar dhe janë prerë, dhe janë shfrytëzuar, dhe sot po rilindin pishat e reja falë politikës së monedhës për pyjet që është vendosur pas 2013. Kështu që është thjesht demagogji politike, se jemi dhe në fushatë. Prandaj faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Markola.

Klementina.

Klementina Meçi : Atëherë përshëndetje.

Meqënëse u ndanë disa mendime dhe objeksione mbi të njëjtin dokument që në dijeninë time dhe sigurisht që të gjithë e kemi marrë, doja të ndaja dhe unë në fakt disa po themi “bullet point” siç e përmendi Burgija. Ky projekt është i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit që tregon për rëndësinë dhe për prioritetin kombëtar të tij. Ky projekt, ndërtimi i këtij resorti pritet që të nxisë një zhvillim ekonomik dhe rrjedhimisht përmes rritjes së turizmit do të rriten edhe punësimet edhe investimet. Janë zbatuar procedurat ligjore dhe proceduriale. Ka pasur koordinim ndër-institucional, mbështetje teknike dhe institucionale dhe parashikohen të krijohen vende pune dhe për të përmirësuar infrastrukturë në njësinë administrative Ishëm. Në fakt nuk gjej absolutisht asnjë arsye për t'u bërë pengesë për kalimin e këtij projektvendimi. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Meçi.

Komente?.....

Dritan Burgija: Mund të flas diçka?

Denisa Luarasi: Po.

Dritan Burgija: Zonja Musaraj, unë e vetmja herë që mora fjalën dhe nuk e ndava në ju dhe ne. Këtu flasim për një ndjeshmëri qytetare, që na prek të gjithëve. Bëra objeksionet e mia. Sa i përket kësaj që u parashtrua tani që do hapen vende pune, shumë dakort që do hapen vende pune, jam i sigurtë për këtë, fola thjesht për ndikimin e prerjeve të pyjeve, ndikimin që do kenë në ambient, në zonat atje, në erozion, në habitat. Hera e parë që flas dhe nuk ndaj Këshillin Bashkiak në dy palë. E fillova fjalën time duke thënë që nëse ne nuk e votojmë ky projekt nuk shkon përpara. Pavarësisht asaj që ju thoni që procedurat janë të tilla, që miratohet këtu miratohet atje. Ne e kemi në dorë këtë punë, shkon apo s'shkon projekti përpara.

Sa i përket ndarjes ju dhe ne, unë jam shumë i qartë që subjekti mund të jetë më shumë ne sesa ju dhe kur vjen puna po bëj objeksionet e mia. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit.

Joniada Musaraj : Atëhere të them të drejtën është hera e parë që dhe unë ja lejoj vetes të them ju dhe ne për të vetmen arsye, sepse njëherë e mirë të merret vesh se kush punon më shumë, kush i përgjigjet qytetarëve, kush ka vendime të drejta, kush ka vendimet e duhura. Kështu që unë prapë e përsëris që ne jemi ne dhe ju jeni ju. Kur keni qenë ju në krye të detyrës, keni patur pushtetin lokal, është harruar në fakt në Durrës, nuk mbaj mend kur, apo pushtetin qëndror nuk keni punuar dhe nuk ju ka rënë mendja jo për pyjet, por në institucionet shtetërore kryesore bazë nuk arrihej dot të hyje, sepse ishin bodrume, ishin të shkatërruara dhe e dini shumë mirë se i keni parë dhe videot. Kështu që të vini sot dhe të më ndaloni mua të përdor në thonjëza, të më ndaloni ju dhe ne. Do ta përdor nga sot e më tutje për sa kohë vendimet që ne marrim si grupim këtu janë të duhurat, janë të drejtat, janë ato të bazuara dhe janë ato me këmbë në tokë. Kaq. Faleminderit.

Dritan Burgija: Një sekond

Llesh Çuni: Ju lutem.

Dritan Burgija: Kam një replikë për znj. Musaraj. Jam dhe kryetar grupi.

Denisa Luarasi: Ju lutem mos ta kalojmë. Mos ta kalojmë.

Joniada Musaraj: Ju lutem kryetare, nuk përmenda emër kështu që nuk i takon.

Dritan Burgija: Shiko, mirë bën që na ndan ne dhe ju se do bëheni gati për opozitë mbas datës 11 maj, që të kthej përgjigje. Bëhuni gati, bëhuni gati që të na ndani ne dhe ju, se prandaj po e bëni po i paraprini gjësë. Dhe do kthehen rolet shumë shpejt këtu në sallë. Faleminderit

Llesh Çuni: Aty mbahu.

Joniada Musaraj: Se kuptoni që ne ju duam dhe aq fortë në opozitë.

Denisa Luarasi: Po zj. Ibraj

Anisa Ibraj: Përshëndetje të gjithëve.

Dhe në fakt unë dua t'ju kujtoj juve në këto dy vite vite se kur erdhët ju dhe ngritët problematika për qytetarët. E vetmja gjë që keni bërë ju është replikë e opozitarëve këtu. Ne kemi ngritur shqetësime, ju na keni replikuar ne. Asnjëri nga ju nuk ka ngritur një problematikë për qytetarët. Unë nuk e di si nuk skuqeni pak kur dilni atje tek qytetarët. Si ju kërkoni votën ju atyre? Asnjë problematikë nuk keni ngritur. E vetmja replikë që keni bërë ka qenë vetëm kur kemi folur ne. Unë nuk e kuptoj domethënë si mund të flisni ju për ne kështu. Puna jonë dallohet dhe në terren edhe kur vijmë këtu dhe flasim për problemet.

Denisa Luarasi : Të kalojmë votim.

Llesh Çuni: Tani, të lutem.

Denisa Luarasi : Tani ju lutemNuk është.... Tani nuk do bëjmë fushatë këtu, sepse nuk keni kërkuar të bëni diskutim.

Llesh Çuni : Jo nuk është punë fushate unë e dua fjalën se jam nga ajo zonë. Jam nga ajo zonë dhe vazhdoj në atë zonë, do të thotë se e njoh shumë më mirë. Jam lind dhe jam rritur në atë zone, edhe unë do vazhdoj.

Dritan Burgija: Se jeton atje s'do të thotë që e njeh.

Denisa Luarasi: Të lutem kërkoje fjalën, shtype. Kërkoje pra.

Llesh Çuni: Unë do ta vazhdoja me ju dhe ne, jo politikisht, po ju dhe ne për afërsinë me pozicionin që diskutohet këtu në projektvendim. Në zonën e Gjirit të Lalëzit dua ta kontestoj fuqishëm atë. Përmend erozion nga fillimi e deri në fund. Si mund të ketë erozion? A e ke idenë ç'do të thotë erozion? Buzë detit në një fushë që është 30 cm mbi nivelin e detit? Nuk ka lidhje fare me zona të pjerrta që mund të ketë erozion. E para.

E dyta përsa i përket ndryshimit të ekosistemit. Unë jam 64 vjeç. Jam lindur dhe jam rritur aty se na paska pasur habitat të çuditshëm atje, që po të hiqen ca pisha, ajo ka qenë perla e bregdetit shqiptar Gjiri i Lalëzit aty ku ka ndërtuar Lura dhe meriton respekt për atë që ka bërë dhe ku

kërkon të investojë përsëri. Është bërë një shkatërrim i llahtarshëm në vitet 90, aty s'ka ngel as 30 % e pishave në atë zonë, meqë e kanë shumë merak këta zotërinjtë.
Kaq.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Tani, nuk mund ta kalojmë në replikë, ju lutem.

Jo jo, shiko, nuk përmendi Burgija. Nuk përmendi emrin.

Të lutem të kalojmë në votim.

Të kalojmë.

Dritan Burgija: Një sekond o Land, vetëm një fjali dhe do të mbaroj.

Meqë ju thashë shparë që kam përgatitur material të gjatë, ma hap pak fjalën të lutem.

Denisa Luarasi: Po.

Dritan Burgija: Po ta thashë shparë që kam përgatitur material të gjatë dhe nuk doja që as juve t'ju lodhja dhe përmenda thelbin e materialit. Po meqë zoti Çuni na përmendi erozionin dhe nuk ka pasur erozion se është, ka lindur ai aty dhe është rritur aty, dhe është bërë 60 e ca vjeç aty. Domethënë aty unë po i përmend ca të dhëna, që ka pësuar Gjiri i Lalëzit dhe erozion intensiv në vitet e fundit. Bregdeti nga Rrushkulli tek plazhi i Shën Pjetrit në grykderdhjen e Ishmit është ngushtuar vazhdimisht rreth 25, ka qenë 100 deri në 200 m të gjëra pjesa e rërës dhe sot është 20-30 m, vetëm kaq. Është studim ky domethënë. Këto.

Llesh Çuni: S'ka lidhje

Dritan Burgija: Si s'ka lidhje.

Llesh Çuni: S'ka lidhje me erozionin, është ngushtuar gjerësia e rërës nga deti.

Denisa Luarasi: Nuk mund të bëjmë debat të tillë, vazhdojmë...

Kalojmë në votim kush është pro pikës 4?

Kundra?.....3

Abstenim?.....

Atëherë 31 pro dhe 3 kundra miratohet pa ndryshim pika 4 e rendi i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 5**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Mustafaraj: Atëherë komisioni ynë edhe pikën 5 e votoi me shumicë votash dhe e parashtron sot për miratim.

Denisa Luarasi : Faleminderit.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Vetëm Tan Burgis i hap mikrofonin.

Dritan Burgija: Shenja të mira këto.

Rolant Xhelilaj: Edhe të jetosh me ëndrra është gjë e mirë. Ëndërra ka efekt shpejt, por ka dhe efekt vite, vite mbrapa dhe ca si Tani janë të rinj dhe do kenë kohë ta kenë kënaqësinë e asaj që ai mendon.

Për pikën 5, komisioni e kalon me votat vetëm të përfaqësuesve të grupit të Partisë Socialiste.

Për pikën 4, në mënyrë shumë miqësore edhe për anëtarët e Partisë Socialiste, ajo goca është e re dhe ka dëshirë të tregojë që ngre probleme. Ne të tjerët s' ngrëmë, ato kanë halle, e tregojnë praktikë. Ne e tregojmë me veprimet, me punët që bën bashkia, që shohin njerëzit, që i kthejnë pastaj në votë.

Por, dua të theksoj një gjë. Teorikisht Tan Burgija sot më pëlqeu. Është çik vonë, po teorikisht më pëlqeu. Problemi që ngriti është i mirë. Kurse për gjërat e tjera ai i di iso. Edhe ai edhe unë jam dakort aty. S'ka as ne, as ju, të gjithë nga 90 e këtej me veprimet e tyre dhe mosveprimet e tyre. Kurse sot ne jemi të qetë dhe marrim ca vendime, sepse janë vendime të studiuara. Janë vendime në vazhdim të punëve të nisura atje, mirë apo keq, por janë të studiuara dhe kanë kërkesa të tilla mbrapa që kthejnë në vlera disa zona, të cilat janë shpyllëzuar me 100.000 lloj formash.

Për pikën 5, ne e komplimentojmë bashkinë edhe për raportin edhe për punën e bërë gjatë vitit 2024. Unë flas në emër të grupit edhe i ftoj gjithë grupin tonë ta votojnë pikën 5.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komente për pikën 5 ? Po.

Po Muka.

Ardian Muka: Atëhere për sa i takon pikës 5, ne dhe gjatë aprovimit, në seancës së aprovimit të buxhetit jemi shprehur kundër buxhetit që bashkia kërkonte të aprovonte. Me thënë të drejtën këtu do fokusohem vetëm në dy aspekte. Natyrisht “Raporti mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për vitin 2024 të Bashkisë së Durrës” është një material goxha voluminoz, por ato çfarë unë shoh është që në pikën karakteristikat kryesore të performancës, të shpenzimeve, pika në faqen 16 për të orientuar kolegët, për sa i takon në lidhje me realizimin e shpenzimeve shohim që asnjë nga zërat nuk është i realizuar në normën 100%. Ka vetëm dy zëra, të cilat shkojnë afër. Një është sport dhe argëtim dhe për këtë dua të përgëzoj ndofta ato pjesë, ato sektorë të bashkisë që kanë realizuar. Megjithatë edhe këtu unë kam dyshimet e mia që mund të kemi arritur deri në këto nivele 98.2%, por përderisa është raportuar kështu dhe është e monitoruar nuk kemi çfarë të themi dhe menaxhimi i mbetjeve, pra menaxhimi i mbetjeve është 95.5%. Ne e kemi denoncuar disa herë këtu me forcë mënyrën se si menaxhimi i mbetjeve në bashkinë Durrës kryhet. Pra për ripërsëritje duhet të kemi parasysh që paguajmë rreth 29€ për ton plus TVSH, plus transport për t'i çuar në Tiranë. Pra, Bashkia e Durrësit pagan rreth 45€ për ton për mbetjet për t'i çuar në Tiranë. Mund të thonë që nuk dalin të gjitha këto nga taksat e qytetarëve durrsak, sepse një pjesë këtij shpenzimi e mbulon qeveria shqiptare. Por në qoftë se qeveria shqiptare do ishte kaq bujare,

ato fonde ne mund t'i kishim marrë dhe të kishim zgjidhur 700 probleme të tjera që kemi në Durrës. Ndërkohë që i marrim dhe i çojmë në një inçenerator tashmë i diskretituar ku nuk besoj që ka njeri sot që thotë që ekziston një inçenerator në Tiranë në Sharrë, ndërkohë që ne vazhdojmë dhe paguajmë 45€ për ton në totalin e vetë si qytet për diçka që, për një shërbim që nuk na jepet. Pra, neve paguajmë me aprovimin e bashkisë këtë shumë në shkelje të hapur them unë të ligjit. Kemi kërkuar dhe kontratën deri sot nuk më është vënë në dispozicion, pavarësisht që ka thënë na jep me shkrim, por kërkesa ime në Këshill Bashkiak është një kërkesë publike. Ajo duhet të ishte marrë dhe të ishte bërë publike në sajtin e bashkisë momenti që një nga këshilltarët, drejtues edhe i komisioneve të Këshillit Bashkiak bën një kërkesë të tillë duhet të ishte bërë publike të nesërmen e kësaj dite dhe jo të presim ne si kërkesa të ndryshme që unë dhe kolegët kemi bërë me muaj dhe akoma nuk kemi përgjigje.

Pra është tek të vetmet zëra që shkon me realizim dhe shohim shumë zëra të tjerë që shumë të rëndësishëm besoj, siç është shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve, e cila nuk ka as parashikim dhe as realizim. Transporti publik po ashtu, furnizimi me ujë dhe kanalizimet po ashtu, pra nuk janë të parashikuara, sepse këto si shërbime jepen nga ndërmarrje aksesore po flasim ndërmarrje mbështetëse të bashkisë, që janë agjensi të ndryshme. Po ashtu përse i takon realizimit ndaj totalit i vetmi zë që ndikon, pra në buxhetin e bashkisë është menaxhimi i mbetjeve. Natyrisht përderisa shkon në në në 95% aty këtu është 24.4% e buxhetit shkon për menaxhimin e mbetjeve. Pra shkon në inçeneratorin e Sharrës, që nuk ekziston. 1/4 e buxhetit të bashkisë shkon në një inçenerator që nuk ekziston dhe për mua kjo është një shkelje flagrante. Është korrupsion, është vjedhje e taksave që i bëhet qytetarëve durrsak.

Për pjesën tjetër kemi mbështetje për zhvillimin ekonomik. Atë që ngrejta për pikën 1 dhe pikën 6, kemi vetëm 0.1%. Pra do ishte në nderin tonë që si këshill, si bashki këtë normë neve ta çonim në atë që do ishte minimumi jetik, ku qytetarët durrsak, ato që janë në nevojë, pra janë në nevojë ekstreme, të jetonin me dinjitet në këtë qytet.

Unë këto kisha. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Muka.

Dritan Burgija : Zoti nënkryetar a mund të përmend dhe unë, që të ktheni përgjigje të plotë pastaj.

Gentian Kallmi : Vetëm që s'ka problem. Doja thjesht një sqarim për Mukën.

Dritan Burgija : Një sekond. Zoti Muka, harroj të përmendi një nga zërat është, janë fondet e rindërtimit që edhe ato janë me mosrealizim. Ndërkohë që qytetarët vijnë në dyert e bashkisë kërkojnë të drejtën e tyre, e drejtë legjitime të rimbursohen. Ju jeni, domethënë riallokoni fondet për 2025-n. Pse nuk i mbaroni punë qytetarëve? Domethënë nga 2019 sot janë 6 vjet.

Rolant Xhelilaj: Janë pak.

Dritan Burgija : Po tashi ju e konsideroni pak. Po unë po flas me shifrat që ju na keni vënë përpara. Më fal. Unë them që ju fondet e rindërtimit i rialokoni për 2025-ën, sepse nuk i plotësohet 2024, nuk shërbehen qytetarët në 2024-ën dhe mendoni që do i shërbeni në 2025?

Pse i leni qytetarët të vërtiten rrugëve dhe të përplasen dyerve të bashkisë pa i mbaruar punë? Kaq. Pyetje e thjeshtë.

Denisa Luarasi : Fjalën e ka nënkryetari.

Gentian Kallmi : Atëherë një sqarim për zotin Muka, i cili në “Raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit” rifuti në lojë menaxhimin e mbjeteve, që është procesi më delikat për qytetarët në shërbim të qytetarëve.

Duhet t’ju sqaroja, përdorni termin inçenerator. Bashkia e Durrës ka lidhur kontratë për depozitimin e mbetjeve urbane në landfillin e Sharrës, kështu që mos të keqpërdorim termit e inçeneratorit. Është një kontratë e pavarur nga kontrata koncesionare. Kjo ishte thjesht për sqarim. Ne depozitojmë në landfillin e Sharrës.

Dhe përse i përket zotit Burgija, të gjithë realokimet që ju përmendni janë kontrata të lidhura në zbatim për të cilat, për disa që nuk arrihet të përfundohen brenda vitit 2024 në respekt të zbatimit të kontratës do financohen, do trashëgohen në vitin 2025. Janë fonde për kontrata të lidhura.

Denisa Luarasi: Faleminderit Nënkryetar.

Po Muka.

Ardian Muka: Faleminderit për sqarimin.

Ajo çfarë unë doja të risqaroja është që është e vërtetë, ne kemi kërkuar atë çfarë dhe kryetarja apo dhe nënkryetari vazhdojnë të na japin sqarim. Pra ka një kontratë, por një kontratë që nuk është publike dhe duke mos qenë kontrata publike lënë vend për shumë aludime, por aludimet tona janë të barazuar në fakte.

Fakti që paguhet 28-29 euro për ton në partencë plus TVSH, plus që ne i transportojmë në inçeneratorin Landfillin inçenerator të Sharrës ka disa tabela në të cilat pasqyrohet qartë se sa janë shpenzimet. Në qoftë se ti do shkosh dhe do inkapsulosh me trajtim të mbetjeve shifër, e cila nuk është 28 euro, 28 apo 29 euro sa është kontrata është kur ti do të inçenerosh.

Megjithatë vazhdoj të ngul këmbë. Do ishte për transparencë ndaj qytetarëve, por jo vetëm. Kontrata duhet të ishte bërë publike në momentin e parë. Që këtu ka pasur hije dyshimi kur ne e kemi kërkuar si këshilltar, si nënkryetar i Komisionit të Zhvillimit Urban të Territorit, kemi kërkuar që të kemi në funksion, të kemi të disponueshme kontratën që bashkia e Durrësit ka bërë me inçeneratorin apo venddepozitimin e Sharrës. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Muka.

Flutura Kasa: Denisa...

.....*Denisa Luarasi hap mikrofonin.....*

Flutura Kasa: Përsa i përket kësaj të rindërtimit, përderisa Zyra e Rindërtimit akoma funksionon, do të thotë që procesi i rindërtimit është akoma në vazhdimësi të dokumentacioneve të qytetarëve. Një pjesë e mirë e qytetarëve, që akoma nuk kanë mbaruar punë, kanë pasur problematika me dokumentacionin, problematika të ndryshme, që lidhen edhe me institucione të tjera, si për shembull me Kadastrën. Kështu që derisa Zyra e Rindërtimit është e hapur, vazhdon punën, kjo tregon që rindërtimi është në vazhdimësi. Jo 6, po mund të shkojnë edhe 10, po mjafton që deri te qytetari i fundit të marri dëmshpërblimin për dëmin, që i është bërë me tërmetin e 2019. Kaq kisha.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Kasa

Dritan Burgjia: Faleminderit. Ishe shumë e qartë.

Denisa Luarasi: Po znj. Ibraj.

Anisa Ibraj: Po. Kam një pyetje tani për këto taksat e mbledhura për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin ku janë përkthyer në shërbim, se po marr shkak zonën e Durrësit të Ri ku dhe vetë kryetarja e bashkisë e ka vizituar në kohën që u bë përmbytja dhe ajo i ka postuar vetë në rrjetet e saj sociale që nuk ka ndriçim. Ka shkuar të takojë banorët dhe nuk i takon dot. Domethënë shkon zonja e takon aty me çizme. Pra edhe po të duam ne të mashtrojmë nuk mashtrojmë dot se janë të postuara.

Tani dy sekonda t'lutem ta mbaroj. Pastaj kjo është edhe gjendja e Durrësit të Ri për pastrimin. Ku përkthehen? Se dhe ata qytetarët e Durrësit të Ri paguajnë taksa, paguajnë taksë për gjelbërimin, paguajnë taksë për ndriçimin, paguajnë taksë për mbetjet. Pse nuk i marrin ata shërbimet? Ku kanë shkuar lekët? Të lutem mund të kthesh përgjigje. Faleminderit.

Gentian Kallmi: Atëherë përsa i përket buxhetit përbëhet nga të ardhura dhe shpenzime. Të gjitha shpenzimet që Bashkia Durrës ka përfshirë dhe investimet janë të pasqyruar në listën e investimeve dhe shpenzimeve.

Anisa Ibraj : Janë të pasqyruara po ne nuk i prekim, nuk i prekim ne këto nuk i shohim...

Gentian Kallmi : Dhe ato janë të realizuara dhe të prekshme ...

.....*shumë zhurmë, flasin të gjithë përnjëherë.....*

Anisa Ibraj: Ti më thua që po gënjej ose po hedh aludime, unë thjesht po tregoj fotot që ka hedh kryetarja.

Gentian Kallmi: Shërbimet, mjafton në shpenzimet në buxhetin e miratuar dhe në shpenzimet dhe investimet e bashkisë Durrës mjafton t'i verifikoni janë të gjitha të realizueshme, të prekshme si investime në infrastrukturë, si investime në shërbime.

Denisa Luarasi : Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 5 të rendit të ditës?.....26 pro ...

Kundra?.....8 kundra.

26 pro, 8 kundra miratohet pika 5 e rendit i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 6**, Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonjës Doçi.

Xhiliola Doçi : Edhe për pikën 6, komisioni jonë ja kalon Këshillit Bashkiak për miratim.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Doçi.

Ka komente pyetje për pikën 6?

Atëherë komente s'ka.

Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 6 të rendit i ditës?.....34

Me 34 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim miratohet pa ndryshim edhe pika 6 e rendit i ditës.

- Përsa i përket **pikës 7**, në mbështetje të pikës 120 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, Datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” citohet:Se për efektet ekonomike dhe financiare, të nxjerrjeve nga përdorimi, njësitë e qeverisjes vendore duhet të informojnë këshillat e njësive vendore.....
Përsa më lart, Qendra Ekonomike e Arsimit ka paraqitur një informacion mbi procedurën e daljes jashtë përdorimit, tjetërsimit të aktive të panevojshme të institucioneve në varësi të Qendrës Ekonomike të Arsimit. Për këtë relaton shefja e financës së Qendrës Ekonomike të Arsimit, zonja Megi Grami. Ftoj zonjën Grami të marrë fjalën.

Megi Grami (Shefe e financës së QEA): Përshëndetje, quhem Megi Grami. Jam shefe e financës tek Qendra Ekonomike e Arsimit Durrës.

Kam ardhur për t'ju informuar mbi një relacion për vlerësimin e nxjerrjes jashtë shpërdorimit të aktive të panevojshme që ka institucioni jonë, ku përfshin të gjithë aktivet e çerdhe, kopshteve, shkollave 9 vjeçare, të mesmet e përgjithshme, të mesmet profesionale. Këto aktive janë të panevojshme për arsye se duke filluar që nga viti i përdorimit me normën e amortizimit plus dhe dëmi financiar që i është bërë nga pjesa e tërmetit. E gjitha relatohet tek informacioni që ju është paraqitur, në bazë të Udhëzimit nr.30 të datës 27.12, dhe të ligjit 139 /2015-s “Për vetëqeverisjen vendore” më lejon Qendrën Ekonomike që titullari i saj të ngrejë si Komisionin e Vlerësimit të këtyre aktive si dhe Komisionin e Nxjerrjes Jashtë Përdorimit. Këto aktive s'janë të nevojshme për arsye se nuk krijojnë kushte të mira për të zhvilluar mësimdhënien për përshtatjen e mjedisit. Pajisje si tavolina, karrige, dollape apo pajisje laboratorike janë, e kanë vlerën shumë më të lartë të riparimit sesa vlera e mbetur dhe për pasojë ato cilësohen si aktive të panevojshme.

I gjithë informacioni ka ardhur nga drejtorat e institucioneve arsimore, nëpërmjet një komisioni që ato ngrejné vetë mbi vlerësimin e aktive, që dëshirojnë që të nxjerrin jashtë përdorimit. Është i përpunuar nga komisioni jonë dhe pasqyrohet si në bilanc të Qendrës Ekonomike si dhe në fletat e inventarizimit të secilat nga shkollat përkatëse.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Grami.

Pyetje? Atëherë ta votojmë. Jo kjo nuk ishte për votim.

Atëherë komente s'kemi. Atëherë mbledhjen e.....

Ardian Muka: Më fal 1 minut mund të marr. Në diskutimet nuk pata mundësi pasi si problematikë ma kanë ngritur dje. Po ju lutem, se është për një pallat tek zona e 2 Ëngjejeve, pallat rikonstruksioni, është firma Kupa, e cila ka zhvilluar, ka fituar tenderin ndërkohë që banorët kanë një problematikë aty. Nënkontraktori, i cili ka zhvilluar punimet prej 1 viti e ca, duhet t'i kishte përmbyllur punimet. Ndërkohë e ka ndërprerë, sepse pretendon që nuk është, nuk janë kryer pagesat. Tashi pagesat normale duhet t'i kryejë firma. Por do të doja një informacion në qoftë se do ishte e mundur nga ana e bashkisë, thashë kjo mua më ka ardhur dje si ankesë nga banorët. Në qoftë se e keni mirë, në qoftë se jo, ta ngrejme pastaj për mbledhjen tjetër.

Denisa Luarasi: Ta lëmë për mbledhjen tjetër, sepse nuk është regjistruar.

Duhet të ishte regjistruar.

Ardian Muka: Ok. Mirë, faleminderit.

Denisa Luarasi : E mbajmë shënim. E mbajmë shënim për mbledhjen e radhës.

Ju falenderoj. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit.

Për mbledhjen e ardhshme do njoftoheni nga Sekretaria nëpërmjet e-mailit.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 18 (tetëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Zv/kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Drejtues i senacës Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak :

DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Këshilltar (Kr. Grupi) :

DRITAN BURGIJA

Këshilltar (Kr. Grupi) :

ROLANT XHELILAJ

Këshilltar (Kr. Grupi) :

FLUTURA KASA